



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 1003/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit C...F...F... L.L.C., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, rr. "...", nr...., kundër debitorit U...F..., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, rr. "...", përfaqësuar sipas autorizimit nga zyra për shërbime juridike A...L..., me seli në Prishtinë, rr. "...", ..., duke vendosur sipas parashtresës së kreditorit e datës 20.09.2021, në lëndën sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr. 461/21, të lejuar me datë 26.07.2021, nga Përmbauesi Privat Mehdi S. Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbarimit sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr. 461/21, të lejuar me datë 26.07.2021, nga Përmbauesi Privat Mehdi S. Reshani, në çështjen përmbarimore të kreditorit C...F...F... L.L.C., me seli në Prishtinë, kundër debitorit U...F..., me seli në Prishtinë, për shkak të tërheqjes së propozimit nga ana e kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar urdhrin përmbarimor P.nr. 461/21, të datës 26.07.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit mbi bazën e Kontratës mbi pengun për sigurimin e kërkesave nga Marrëveshja e kredisë nr.724, e datës 30.10.2017, e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut sipas konfirmimit mbi regjistrimin e pengut me numër R-20171101-256, e datës 01.11.2017, i cili dokument paraqet dokument përmbaues në bazë të nenin 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbartimit, debitori brenda afatit ligjo ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi nuk ka tipare të përmbartueshmërisë.

Kreditori, përmes parashtresës të dorëzuar pranë përmbartuesit privat me datë 20.09.2021 ka tërhequr në tërësi propozimin për përmbartim ndaj debitorit për shkak të përmbushjes së detyrimit, ndërsa ka kërkuar nga gjykata që tërheqja e propozimit të aprovohet dhe lënda ti kthehet përmbartuesit privat.

Prandaj, gjykata pas pranimit të tërheqjes së propozimit për përmbartim të paraqitur me datë 20.09.2021, nga kreditori C...F...F... LLC, vlerësoi se janë plotësuar kushtet për përfundimin në tërësi të procedurës në këtë çështje juridike përmbartimore në kuptim të nenit 42, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbartim organi përmbartues e përfundon përmbartimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht”*.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr 1003/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.